



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Nr. 2835 Prot

Kukës, 07.06.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit:

Projektvendim

“Për dhënien në përdorim të një sipërfaqe 0,5 HA nga fondi pyjor/kullosor, për objektin HEC “MALLA” (shtesë) në funksion të aktivitetit të shoqërisë “GJURR REÇ” Sh.P.K

Propozuesi i konsultimit:

Këshilli Bashkiak

Informacion për konsultimin:

Në ekonominë pyjore/kullosore Arrën, ushtron aktivitetin Shoqëria “GJURR REÇ” Sh.P.K me objekt HEC “MALLA”. Subjekti ka kërkuar nga Bashkia Kukës, marrjen me qira të tokës pyjore që preket nga ndërtimi i kanalit të HEC-it, konkretisht ngastrat 41/b, 44/b, 47/b, 51/c, 52/a, 52/c, 53/a, 56/a. Përpara shqyrtimit të këtij projektvendimi, Këshilli Bashkiak organizon takimin me banorët e Njesisë Administrative Arrën (fshatrat e kësaj njësie), të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke dhënë mendimet, rekomandimet e sugjerimet e tyre.

Vendi, koha e konsultimit:

Konsultimi do të organizohet ditën e enjte, me datë 27.06.2024 ora 14⁰⁰ në qendër të fshatit Arrëz.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët:

Kryetari/Anëtarëte Këshillit Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisw/Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Nga të ftuarit:

Banorë të Njesisë Administrative Arrën, Kryetarë e Anëtarë të Kryesive të fshatrave, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Forma e konsultimit:

Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjet e komisionit përkatës dhe mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit

Albert MUJA

